REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr6577/1 Prot Maliq ,më 02.11.2026

VENDIM

Nr 133, datë 30.10.2026
Për
Miratimin në parim, të zhvendosjes së lapidarit, që ndodhet në pasurinë nr. 1397, zk. 1667, fshat Maliq, në vendndodhjen e re në pasurinë nr. 28, zk. 1667"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", nenit 23, pika 14, nenit 25, pika 1 dhe 2, nenit 54, Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, si dhe shkresës nr.6120/1 prot., datë 30.10.2026 "*Kërkesë për zhvendosjen e lapidarit në fshat Maliq",* të Bashkisë Maliq, këshilli i bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të zhvendosjes së lapidarit, që ndodhet në pasurinë nr. 1397, zk. 1667, fshat Maliq, në vendndodhjen e re në pasurinë nr. 28, zk. 1667"
2. Arsyeja e zhvendosjes të lapidarit në fshat Maliq është për shkak të mos pasjes akses në vendodhjen aktuale, si rrjedhojë e pozicionimit midis pasurive pronë private.
3. Bashkia Maliq të marrë të gjitha masat teknike dhe financiare për zhvendosjen dhe rivendosjen e objektit në përputhje me normat për ruajtjen e integritetit të tij.
4. Projekt-vendimit i bashkëlidhet plani i rilevimit dhe planvendosja e pasqyrimit të vendodhjes aktuale të lapidarit dhe ku parashikohet të zhvendoset në fshat Maliq.
5. Ngarkohen Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Agjencia e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Maliq, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.11.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ